


Situata e Tregut të Punës gjatë vitit 2013

Një paraqitje faktike i disa treguesve të rëndësishëm të tregut të punës ndarë sipas kategorive të sektorëve industrialë, moshës, gjinisë dhe shërbimeve.

Gjatë 2013 punësimi në vend pësoi rënie dhe u fokusua kryesisht në pesë sektorë industrialë: industria përpunuese, ndërtimi, arsimi, tregtia me shumicë e pakicë si dhe administrata publike. Pothuajse gjysma e të punësuarve, tre nga shtatë persona, ishin pjesë e një prej këtyre sektorëve industrialë.


- **Sektori bujqësor përmbante pjesën më të madhe të punësimit me 44.6%, shërbimet ishin të dytat me 37.9%**
- **Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës ishte 59,9% (70,2% për meshkujt dhe 50,4% për femrat)**
- **Të punësuarit kundrejt pagës përbënin 40.2% të totalit**
- **Të vetpunësuarit përbënin 25.6% të totalit**
- **Punëtorët pa pagesë në familje përbënin mbi 1/3 e totalit (34.2%)**

Punësimi sipas Sektorëve Industrialë



Punësimi i të rinjve mbeti problem për shumicën e vitit 2013. Kjo ishte në vazhde të rënies së punësimit në total për popullsinë në moshë pune. Punësimi i femrave u ul më ndjeshëm se ai i meshkujve. Gjatë tremujorit të fundit u vu re një rritje e lehtë e punësimit të meshkujve.

Shkalla e Punësimit sipas Gjinisë



- **Nga T1 deri T3 të 2013 punësimi i të rinjve ra nga 32.8 % në 27.4%**
- **Veçanërisht rënia e punësimit vërehet tek femrat e reja, nga 28.8% në 21% brenda vitit**
- **Punësimi për femrat zbriti nga 47.3% (T1-2013) në 40.7% (T4-2013)**
- **Për meshkujt, shkalla e punësimit u ul nga 61.6% (T1-2013) në 57% (T4-2013)**
- **Trendi i rënies filloi të thyhej në tremujorin e fundit të 2013**